



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.67/2016

Prishtinë, më 13.9.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, Sala Berisha-Shala dhe Duda Balje, anëtarë.

I ftuar: z.Avdullah Hoti, ministër i Ministrisë së Financave.

Pjesëmarrës të tjerë: Lekë Musa – Kabineti i Kryetarit; Ilir Rama – MF, Blerta Bejtullahu – EUSK; Dardan Abazi - INDEP, Sylejman Blaku – Kosova Sot; Etleva Malushaj – LVV dhe Fjolla Uka – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 2.8.2016;
3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/106, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë “Envidity Energy Kosova LLC”;
4. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.06/106, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë “Sharr cem” dhe “Titan America”;
5. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Raif Qela, lidhur më rendin e ditës, kërkoi që të diskutohet për Projektligjin për “Trepçën”, pasi tha se jemi në gjysmën e shtatorit, ende nuk është proceduar Projektligji për “Trepçën” nga Qeveria për në Kuvend për miratim, dhe afati për likuidim po afrohet, që është data 2 nëntor 2016. Ai propozoi që të kërkohet një informatë nga Qeveria se kur do të procedohet ky Projektligj për në Kuvend.

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, tha që ashtu siç jeni të informuar edhe ju në vazhdimësi është duke u punuar nga ana e Qeverisë dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit – AKP-së, për “Trepçën”. Është hartuar dhe ekziston një draft i Projektligjit që ka bërë më “Trepçën”.

Natyrisht që kemi pak vonesë, por Qeveria dhe Kuvendi i kanë të gjitha instrumentet që “Trepça” të mos lejohet të shkojë në likuidim. Prandaj, duhet të konsultohen të gjithë aktorët nga Qeveria, Kuvendi dhe Bashkësia Ndërkombëtare, sepse është çështje vitale e vendit ruajtja e tërësisë së “Trepçës”.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 2.8.2016;

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 2.8.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Vendimit të Qeverisë nr.05/106, datë 25.8.2016, me të cilin konstatohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë “Envidity Energy Kosova LLC”;

Kryetari, tha se lidhur më këto dy pika e kemi ftuar ministrin e Financave, z.Avdullah Hoti, për të paraqitur arsyetimin e Qeverisë për këto dy vendime. Pastaj ai ia kaloi fjalën që të prezantojë ekspozetë e këtyre dy vendimeve të Qeverisë dhe kërkoi nga deputetët që dy pikat të diskutohen përnjëherë.

Avdullah Hoti, ministër i Financave, tha se sipas Ligjit 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, të ndryshuar me Ligjin 04/L-158, neni 18, paragrafi 1, të gjitha licencat për hulumtimin ose shfrytëzimin e një minerali energjetik ose një minerali i cili ndodhet në një zonë e cila është përcaktuar si “zonë me interes të veçantë” jepen vetëm pas zhvillimit të një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues të tenderimit. Procesi konkurrues i tenderimit ushtrohet nga Komiteti për Partneritetet Publiko-Private (KPPP), i themeluar sipas Ligjit për Partneritetet Publiko-Private, neni 18, paragrafi 3. Si përjashtim, procesi konkurrues i tenderimit nuk zbatohet për një licencë për një mineral energjetik, nëse për shkaqe që ndërlidhen drejtpërdrejt me nevojën për të siguruar sigurinë e furnizimit energjetik ose tërheqjen e investimeve të konsiderueshme direkte në Kosovë. KPPP-ja ka të drejtë që t’ia rekomandojë Qeverisë vendimin për aprovim me të cilin konstaton se ka interes publik në lëshimin e kësaj licence për një investitor specifik (neni 18, paragrafi 7). Me rastin e marrjes së një vendimi të tillë nga Qeveria, atëherë të njëjtin e dërgon për miratim përfundimtar në Kuvend. Pas miratimit nga

Kuvendi, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) duhet t'ia lëshojë licencën atij investitori, me kusht që kushtet e licencës të jenë në përputhshmëri me dispozitat e aplikueshme të këtij ligji dhe investitori i përmbush të gjitha kriteret e kualifikimit të përcaktuara sipas këtij ligji.

Roli i KPPP-së sipas nenit 18, paragrafi 8, të Ligjit si më sipër është që të konstatojë se ka interes publik për lëshimin e licencës për një mineral energjetik nga KPMM-ja, pa kaluar nëpër procedurën konkurruese të tenderimit. Konstatimi i KPPP-së është i natyrës rekomanduese, sepse vendimin përfundimtar e merr Kuvendi i Kosovës pas miratimit të rekomandimit të KPPP-së nga Qeveria e Kosovës. Kuvendi i Kosovës vetëm miraton anashkalimin e procedurës konkurruese të tenderimit. KPMM-ja prapë duhet të sigurohet që investitori i plotëson të gjitha kushtet për lëshimin e licencës sipas Ligjit për Minierat dhe Minerale. Pas nxjerrjes të një vendimi nga Kuvendi, Qeveria mund të hyjë në një marrëveshje për investim me investitorin specifik me kusht që ajo marrëveshje për investim është në përputhshmëri me Ligjin e aplikueshëm, marrëveshja për investim plotëson kushtet e licencimit të përcaktuara me ligj, dhe marrëveshja për investim përfshinë përfitime si dhe shpërndarje optimale të rrezikut për Republikën e Kosovës, duke tërhequr investime të konsiderueshme direkte apo sigurimin e sigurisë së furnizimit energjetik.

Ligji për Minierat dhe Minerale i ka caktuar dy kriteret se kur ka interes publik për të anashkaluar procedurën konkurruese të tenderimit. Kushtet janë që projekti për të cilin kërkohet licenca është i nevojshëm për të siguruar sigurinë e furnizimit energjetik në Republikën e Kosovës ose do të kontribuojë në tërheqjen e investimeve të konsiderueshme të drejtpërdrejta në Kosovë.

Sa i përket kriterit të dytë, KPPP-ja ka përcaktuar disa kriteret objektive, specifike dhe të matshme për të vlerësuar se çka mund të cilësohet si investim i konsiderueshëm për të cilin ka interes publik që të anashkalohet procedura konkurruese e tenderimit. Për nevojat e përcaktimit se çka është investim i konsiderueshëm, projekti-vendimet e propozuara kanë adaptuar kriteret të veçanta për investimet strategjike, për investimet në sektorin energjetik. Të dy rastet janë të ngjashme dhe mund të zbatohen në mënyrë analoge, sepse kanë të bëjnë me caktimin e interesit publik për tërheqjen e investimeve në sektorin e energjetikës. Sipas kësaj, kriteret për përcaktimin e interesit publik për vlerësimin nëse një projekt do të kontribuojë në tërheqjen e investimeve të konsiderueshme të drejtpërdrejta në Kosovë janë si në vijim: Projekti ndihmon në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Republikës së Kosovës, duke ndikuar në përmirësimin e kushteve dhe standardeve të prodhimit të mallrave, ofrimit të shërbimeve dhe në përmirësimin e përgjithshëm të kualitetit të jetës së qytetarëve dhe mbrojtjen e ambientit; Projekti inkurajon futjen në përdorim të teknologjive të përparuara, të cilat do të ndikojnë në rritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të ekonomisë së Kosovës dhe në uljen e deficitit tregtar; Projekti ka vlerë kapitale prej jo më pak se 30.000.000 (tridhjetë milion) euro, dhe ka potencial të krijojë të paktën 80 (tetëdhjetë) vende të punës, pasi që të fillon fazën me e shfrytëzimit të mineraleve energjetike; Projekti është në pajtim me standardet mjedisore të përcaktuara me legjislacionin e Republikës së Kosovës dhe të Bashkimit Evropian; Projekti nuk është në kundërshtim me detyrimet e Republikës së Kosovës, të përcaktuara me konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Pra Qeveria do të themelojë një ekip për përgatitjen dhe negociimin e marrëveshjes i cila në versionin e saj final duhet të aprovohet nga Qeveria. Kompania propozuese: “ENVIDITY ENERGY KOSOVA LLC”, është kompani kanadeze me seli në Alberta. Kompania “Envidity” në maj të vitit 2013 ka parashtruar 3 aplikacione për licencë hulumtimi pranë KPMM-së. Sipërfaqja për të cilën ka aplikuar kjo kompani është e

përshkruar në aplikacion dhe lidhur me këtë eksperti i gjeologjisë ka bërë elaborat. “Envidity” ka shprehur interesim për gazifikimin nëntokësor të qymyreve të Kosovës dhe prodhimit të gazit sintetik (syngas), dizelit dhe kerozinës.

Ministria e Financave, me këtë rast ka kërkuar vlerësimin e këtij projekt propozimi nga aspekti ligjor, teknik dhe financiar. Kjo kompani gjithashtu ka dhënë një prezantim të projektit të datës janar 2015, në të cilën prezantohet projekti i kësaj kompanie në pika të përgjithshme. Projekti ka të bëjë me gazifikimin e thëngjillit nëntokësor përmes metodës teknologjike e cila mundëson prodhimin e naftës sintetike (dizel) nga procesi kimik i gazifikimit të thëngjillit. Metoda kimike është e përshkruar në përgjithësi në propozimin e lartcekur. Gjithashtu në mënyrë të përgjithshme është përshkruar edhe teknologjia e cila do të zbatohet. Sa i përket implementimit, sipas këtij propozimi, “Envidity” do të implementojë projektin në dy faza. Në fazën e parë, kompania synon të prodhojë 1,200 barel derivate në ditë, kurse në fazën e dytë synon të prodhojë 20,000 barel derivate në ditë. Sipas informatave të ofruara nga kompania, përfitimet mund të llogariten si më poshtë: Investimet e huaja - Faza I - 1200 bpd + 20-28 MWe (\$130 - \$150 million); Faza II – 20,000 bpd + >600 MWe (\$ 1.8 - \$2.0 billion); Faza III – >50,000 bpd + >1000 Mwe (>\$5 billion). Gjenerimi i vendeve të punës - Faza I: 500 ndërtimtari + 100 vende pune; Faza II: 3500 ndërtimtari + 300 vende pune; 3 – 10-fish ndikim indirekt në gjenerim të vendeve të punës dhe investimeve, me përfitim lokal dhe rajonal si dhe në nivel kombëtar. Ndërsa, përfitimet sociale janë: vetëmjaftueshmëri e lëndës djegëse për transport, më pak ndotje e ambientit dhe kualitet më i mirë i jetës, zvogëlim i emetimit të gazrave dhe emetim më i ulët i karbonit. Kompania propozuese: “SHARR CEM & TITAN AMERICA”, përmes propozimit investues “Prometheus” ka shprehur interesimin për eksploatimin, terjen dhe pulverzimin e qymyrit nga baseni qymyror i Dukagjinit, gjegjësisht nga fushat Tuqep - Kusar. Projekti parasheh që produktet finale të përdoren për nevoja vetjake në prodhimtarinë e “Sharr cem”, për t’ua shitur impianteve tjera të “Titan Grupit” në rajon dhe subjekteve të tjera prodhuese të interesuara. KPPP-ja përmes DQPPP/Ministrisë së Financave, me këtë rast ka kërkuar vlerësimin e këtij projekt propozimi nga aspekti ligjor, teknik dhe financiar. Sipas materialeve të paraqitura dhe prezantimeve, kompania “Sharr cem Sh.p.k. (“Sharr cem”) kërkon të marrë licencën e shfrytëzimit për një sipërfaqe të padefinuar në këtë propozim, me qëllim të mihjes së thëngjillit dhe përpunimit të tij në lëndë energjetike. Për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme për mihje, “Sharr cem”-i propozon që në fazën fillestare të investojë 4 milionë € (faza nr. 1). Në fazën e mëtejshme, “Sharr cem” zotohet që të investojë 30 milionë € në teknologjinë e terjes së thëngjillit dhe zvogëlimin të lagështisë së thëngjillit deri në 13% (faza nr. 2). Në fazën finale, “Sharr cem”-i zotohet të investojë 15-35 milionë € në teknologjinë e bluarjes së thëngjillit, prodhimit të thëngjillit të imët për djegie. “Sharr cem”-i synon që këtë produkt ta plasojë në treg për shitje dhe një pjesë të saj ta përdorë për nevoja të veta. Me qëllim të realizimit të këtij projekti, “Sharr cem” kërkon që të aplikojë për licencë hulumtimi sipas Ligjit për minerale dhe të marrë atë licencë pa zbatuar procedurat e tenderit të hapur dhe konkurrues. Kompania “Sharr cem”, respektivisht kompania “Titan Group”, sipas prezantimit të dorëzuar, kanë mbi 100 vjet përvojë në sektorin minerar/prodhues si dhe janë pjesë e organizatave të ndryshme botërore që kanë të bëjnë me implementimin e strategjive të ndryshme për mbrojtjen e mjedisit, minimizimin e efekteve negative si dhe të përgjegjësisë sociale ndaj komunitetit dhe vendit ku operojnë. Kjo lëndë djegëse do të mund të shfrytëzohet nga e tërë industria në Kosovë. Sipas informatave shpesh të furnizuara nga “Sharr cem”, sipas modelit financiar preliminar, parashikohet që projekti “Prometheus” gradualisht të rris numrin e punëtorëve, duke filluar nga 30 deri 150.

Problem themelor në Kosovë është papunësia. Projekti do të fillojë së punësuar 30 të punësuar si dhe në mënyrë progresive do të rris numrin deri në 130 të punësuar. Kostoja e fuqisë punëtore gjatë kësaj periudhe është kalkuluar diku përafërsisht 40 milionë euro. Duke u bazuar në sasinë e dhe nivelin e ekstraktimit të thëngjillit, projekti do të kontribuojë buxhetit të Kosovës së paku 70 milionë euro në formë të pagesës së tantumës për thëngjillin e ekstraktuar. Projekti do të kontribuojë Qeverisë së Kosovës së paku 8 milionë euro në formë të tatimit në të ardhura të korporatave, duke mos përfshi tatimin në paga, TVSH-në si dhe forma tjera të taksave komunale.

Muhamet Mustafa, kryetar, falënderoi ministrin për prezantimin dhe tha se meqë sot në rend dite kemi projekte të rëndësishme, do të thotë roli jonë sot është praktikisht me aprovimin apo refuzimin e projekteve. Ne kemi të bëjmë me një procedurë e cila mundësohet me Ligj, që duhet ta aprovojmë në bazë të Komitetit të Vendimit dhe sugjerimit të Komunitetit Ndërminstor dhe Qeverisë së Kosovës. Prandaj, këtu duhet të fokusohemi në konstatimin e një interesi publik, në mënyrë që këto procedura të zhvillohen sipas mënyrës të përcaktuar me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Siç theksohet edhe në materialet që i pamë, kemi të bëjmë me projektet që kanë një rëndësi të madhe sa i përket energjisë. E dyta kemi të bëjmë me teknologji të avancuar dhe me investitorë të rëndësishëm që kanë një brend dhe kanë një rëndësi për neve. Natyrisht që fazat e mëtejme nëse këto projekte i plotësojnë kushtet për marrjen e licencës sepse është KPPM-ja e cila do të vendosë pas vendimit tonë lidhur me licencën.

Janë disa elemente që dëshiroj t'i diskutojmë edhe me kolegë edhe me juve. E para, ne duhet të kemi sipërfaqe të përkufizuar, jo sipërfaqe të padefinuar, në qoftë se diskutojmë qoftë për një licencë, qoftë për hulumtime qoftë për eksploatim. Deri në vendosjen e KPPM-së sipërfaqja duhet të definohet. Kjo do të jetë çështje e zhvillimit urban dhe çështje e shpronësimit kush do ti bëjë shpronësimet. Më tutje sigurisht kemi punë në qoftë se Qeveria hyn në negociata, KPPM-ja e gjen të arsyeshme, atëherë ne do të përgatitemi shumë mirë për negociata me investitorët për arsye se janë projekte shumë të rëndësishme. Jo vetëm investitori por edhe Qeveria do të bëjë një studim fizibiliteti që të shoh kostot sociale dhe ekonomike. Mandej, vlerësimi strategjik i mjedisit patjetër si metodologji që është moderne. Sepse këtu nuk shoh shumë probleme të ndotjes sa shoh probleme të zhvillimit urban. Sepse targetohen sipërfaqe të caktuara, të cilat mund të jenë të banuara. Përgjithësi mendoj se sot kemi të bëjmë me vendime të rëndësishme të cilat ndoshta shënojnë një fazë të re tërheqjes së investimeve të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës. Duhet të përgatitemi, t'i ndërtojmë kapacitetet negociuese dhe menaxhuese me investitorë tjerë të rëndësishëm të cilët i kemi sot dhe në të ardhmen pas aprovimit të Ligjit për Investime strategjike.

Raif Qela, tha se kemi para nesh dy propozime për projekte me rëndësi siç e tha edhe kryetari, me rëndësi mjaft të madhe për të ardhmen e Kosovës. Nga ana ligjore çdo gjë është në rregull edhe nga ky aspekt nuk kemi as mundësi të bëjmë pengesë në atë kuptimin që është çdo gjë në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale, sidomos pas miratimit të Ligjit për investime strategjike. Por që ka shumë çka të diskutohet ka shumë pikëpyetje në krejt këto dy projekte. Problemi kryesor është se gjithkund në botë ka vërejtje dhe kritika të mëdha për këtë proces për gazifikimin nëntokësor të qymyreve dhe kjo nuk është vetëm prej shoqërive ambientaliste, por është edhe prej shkencëtarëve, të cilët vijnë në përfundimin se pasojat për ambientin mund të

jenë fatale për atë vend po që se nuk ndërmerren masat paraprake shumë të rrepta. Me këtë që na është ofruar këtu, nuk shoh se kemi saktësi në atë se çka do të investohet, në çfarë fushash do të investohet. Respektivisht çfarë teknike dhe çfarë teknologjie do të përdoret për gazifikimin nëntokësor dhe për prodhimin e gazit sintetik të tillë si kerozina sintetikë. Shumë shtete të botës të cilat kanë probleme me ndotjen nëpër qytete të mëdha prodhojnë në pjesë që janë jashtë, larg zonave urbane, e bëjnë gazifikimin e qymyreve dhe prej tij nxjerrin prodhojnë gaz sintetik etj., në mënyrë që qytetet të kenë lëndë djegëse shumë ambientalisht më të përshtatshme.

Dyoksidi i karbonit i emetuar prej gazifikimit nëntokësor është shumë më i lartë se sa i prodhimit tradicional, respektivisht djegies tradicionale të qymyrit për nevojat e energjisë në fushat e tjera. Pastaj, efekti serrë që është problemi i krejt botës. Por, në fund të fundit efekti serrë është problem dytësor. Ndotja e ujërave nëntokësore, ndotja e ujërave sipërfaqësore, rreziku për shembje, respektivisht gjeomorfologjia ka mundësi të ndryshojë. Krejt këto aspekte duhet paraprakisht të dihet se çka do të bëhet me to në mënyrë që ne t'i jepim fund këtyre dy projekteve. Po them dy projekteve sepse janë të përafërta. Nga aspekti i zhvillimit afatshkurtër ekonomik ka mundësi që edhe përfiton shumë, por aspekti afatgjatë i përfitimeve mund të jetë i diskutueshëm sepse nga ndotja e ambientit mund të mbesim pa burime uji, mund të mbesim me pasoja shumë të mëdha afatgjate për ambientin. Prandaj, duhet këtë çështje ta studiojmë mirë. Nga ana ligjore edhe ekziston nevojë për furnizimin me energji. Kurse energjia e prodhuar prej kësaj nuk është energji shumë deficitare në Kosovë ngase ne nuk kemi problem me furnizim të lëndëve djegëse. Këto lëndë djegëse do të shkojnë për eksport padyshim pjesa më e madhe. Në Kosovë duke qenë se lëndë djegëse të zakonshme janë më të lira. Vetëm pak po të jenë më të lira, pjesa dërmuese e qytetarëve nuk do ta shfrytëzojnë lëndën djegëse e cila do të jetë ambientalisht më e favorshme sintetike.

Pastaj, vet procesi që tregon se bëhet me djegie të kontrolluar nëntokësore në temperatura 700-900 shkallë celsius, diku deri në 1500 celsius me presion të madh tregon se aty bëhet një shpenzim i energjisë, energji e cila është e pakthyeshme. Pjesa më e madhe e atyre baseneve më nuk mund të shfrytëzohen edhe ato që shfrytëzohen, shfrytëzohen sa shfrytëzohen ato të cilat janë më të volitshme për investitorin.

Është e vërtetë se ka mundësi, nëse investohet në këtë projekt mund të bëhet kontrolli më i madh i ndotjes në raport me emetimin e squfurit, oksideve të azotit edhe zhivës. Porse kjo nuk mund të bëhet nëse nuk sanksionohet me termat e referencës.

Rezervat qymyrore me parametra të trashësisë shumë të vogla nuk mund të shfrytëzohen me teknologji tradicionale. Kosova pjesën më të madhe të rezervave i ka shumë në sipërfaqe të tokës dhe nuk ka nevojë për investime të mëdha për t'i nxjerr ato. Prandaj, kjo është e leverdishme vetëm aty ku mundësia për t'i nxjerr ato është tepër e vogël ose është me kosto shumë të lartë financiare...

Muhamet Mustafa, tha se këto janë çështje të cilat janë dilema teknologjike të cilat dikush thotë kështu e disa ashtu. Ne duhet e edhe Qeveria, t'i vlerësojmë këto kur ta kemi studimin e fizibilitetit. Sot kemi punë vetëm procedurale dhe këtu duhet të përqëdrohet diskutimi.

Raif Qela, vazhdoi duke thënë se “The Lack of Possibility of Clear Determination at Investment Preparation Stage of Enviromental Related to Risk Construction, Operation and Demcompetition of the Plant, me fjalë të tjera pa u saktësua qartë se çka do të investohet, cila do të jetë teknologjia e prodhimit, unë mendoj se nuk duhet t'ja japin votën për nëse nuk duam të

hymë në rreziqe të mëdha edhe me mundësi që të ketë pasoja të mëdha afatgjata për Kosovën. Prandaj, edhe unë ju propozoj mos t'ngutemi, ta analizojmë mirë dhe shkencëtarët duhet të involvohen në këtë debat. Ta sqarojmë mirë se a do të ketë pasoja ambienti e ardhmja e Kosovës prej kësaj në mënyrë që ne ta kemi ndërgjegjen e pastër për çka po votojmë.

Muhamet Mustafa, tha se një sqarim ka ministri.

Avdullah Hoti, ministër i Financave, tha se ky është projekt që është dorëzuar në Qeverinë paraprake qysh në vitin 2013. Është shqyrtua, kanë filluar fazat e para dhe menjëherë në janar të vitit 2015 kemi nis shqyrtimin e këtyre dy projekt propozimeve. I kemi kontraktuar ekspertët e pavarur për të studiuar në aspektin juridik të implementimit të lëshimit të licencave, aspektin teknik dhe teknologjik e edhe aspektin ambiental. Për sqarim tuajin në këtë fazë ju nuk e aprovon përfundimisht projektin. Ne vetëm në fakt vetëm kemi kërkuar që Kuvendi, pra Komisioni të aprovojë kërkesën për shprehjen e interesit publik. A ka interes publik nga implementimi i këtyre dy projekteve? Janë dy kriteret. E para që siguron furnizim stabil me energji dhe e dyta që është investim substancial në ekonomi. Nuk është në kundërshtim me strategjinë e zhvillimit të energjisë në Kosovë. Komiteti ka vendosë, për këto dy projekt propozime, Qeveria e ka miratuar. Ajo që kërkohet është vendimi i Kuvendit për të miratuar këtë vendim tuajin e pastaj të Qeverisë, dhe pastaj themelimi i një ekipi negociues për tu plotësuar krejt këto kushte që ju me të drejt i përmendët. Në këtë fazë vetëm po kërkojmë që mos shkojmë në procedura tenderuese, por të negociojmë drejtpërdrejt me investitorët dhe nuk do të ketë asnjë anashkalim të asnjë kriteri ligjor, teknik, ambiental, që kërkohet në raste të tilla.

Blerim Grainca, tha se vërtet investimet janë prioritet edhe i Qeverisë edhe këtij Kuvendi. Unë e përgëzoj ministrin për prezantimin e këtyre dy projektet. Megjithatë, mendimi im është i ndarë sa i përket dy projekteve. Derisa, projekti që lidhet me “Sharr cem”-in, është një projekt pak më i prekshëm, më i arsyeshëm, kompania është këtu dhe për me thjeshtua diskutimin, do ta bëjë nxjerrjen dhe terjen e thëngjillit d.m.th. është proces pak më i lehtë.

Te kompania tjetër “Envidity”, unë kam shumë dilema dhe më lejoni që ti ndaj me juve. Ka një mospërputhje apo dualizëm të përshkrimeve që u bëhet të dy projekteve, p.sh. nëse e shikojmë deklaratën e pajtueshmërisë që ka dhënë Komiteti përkatësisht Ministria e Financave, shohim se te pika C, të dy projekteve thuhet se po investohet 30 milionë euro. Do të thotë, ose është një gabim teknik që duhet ta korrigjojë Qeveria sepse duhet edhe “Sharcemi” të investojë 30 milionë euro e edhe Kompania “Envidity” 30 milionë euro, që mendoj se është një gabim teknik.

Avdullah Hoti, Ministër i Financave, është e drejt plotësisht. Nuk është gabim. Kushtet minimale që duhet përcaktohen që janë plotësua nga dy projektet. Mandej për secilin projekt jepen sqarimet veç e veç.

Blerim Grainca, pyeti “Envidity” nga përshkrimi që i është bërë është kompani kanadeze. Mirëpo, në hulumtimet që mund të keni bërë edhe ju edhe ne nuk mund të gjendet asnjë projekt i tillë që ka bërë “Envidity” diku nëpër botë. Nuk ka eksperiencë të kësaj fushe. Po ashtu, u tha se janë dhënë realisht disa përshkrime të praktikave të tilla në botë, mirëpo, kjo kompani “Envidity” nuk mundi të gjejë askund se ka realizuar një projekt të tillë dhe ka një eksperiencë në këtë fushë.

Edhe nga studimi i materialit shihet se nuk është e përfshirë asnjë e dhënë për impaktin mjedisor- social, qoftë edhe fizibiliteti që mund bëhet në të ardhmen, ngase pa u bërë hulumtime nuk mund të bëhet fizibiliteti.

Prodhimi i gazit sintetik gjegjësisht i derivateve është goxha një proces i komplikuar, që nuk i jap vetës të drejtë të në aspektin teknologjik të flas. Mirëpo, janë disa dilema që duhet me i sqarua, dhe ajo që u tha në fillim, që është pjesa e eksproprijimeve, duhet ta keni shumë të qartë kush e bën këtë punë. A është pjesë e projektit apo nuk është pjesë e projektit? Sepse një kompani sikur kjo që është “Envidity” e energjisë, zotëri ministër është e regjistruar në vitin 2013. Ka zero euro qarkullim dhe thotë se kontribuoi 8 miliardë investime për vitet e ardhshme. Unë mendoj se pas këtij vendimi qoftë Qeveria, qoftë Komiteti i Partneritetit Publiku Privat, kushtin e parë gjatë negociatave që duhet ta kërkojë, është burimi i financimit. Sepse për mua është një dilemë, si arrin një kompani që në 2013 e regjistruar, të investojë 8 miliardë investime në 4 ose 5 vitet e ardhshme. Po ashtu kam dilemë të jashtëzakonshme që lidhet me hapësirën që ka kërkuar. Ju e dini që Ligji për Miniera dhe Minerale është amendamentuar dhe lejon deri në 200 hektarë plus nëse nuk gaboj. Ndërsa, në kërkesën që ka bërë “Envidity”, sa e pashë këtu janë mbi 30 kilometra katrore, që janë mbi 100 hektarë.

Muhamet Mustafa, tha se ligji do të zbatohet.

Blerim Grainca, tha se kjo hapësirë nëse konvertohet në kilometra katrore parasheh një përqindje bukur të madhe të territorit të Dukagjinit, që mendoj se është e papranueshme që një kompani e tillë, një ekskluzivitet i tillë qoftë edhe për hulumtime ministër për një sipërfaqe që përfshin më shumë se dy komuna të Republikës së Kosovës dhe mendoj se kjo duhet të sqarohet. Pastaj, kjo çështja e investimeve, Komiteti PPP, duhet ta ketë parasysh rastet kur fantom kompanitë po vinë në Kosovë dhe të cilat më pastaj po tërhiqen. Ju e dini rastin e Brezovicës, e kemi rastin e Postës, i dini këto dilema, prandaj, dilemat e mia kanë të bëjnë me burimet e financimit, sipërfaqen katrore, impaktin mjedisor edhe me të kaluarën e kësaj kompanie dhe besoj që falë punës së mirë që keni bërë deri tash si ministër, të arrini që edhe këto dilema t’i sqarojmë në mënyrë që Kuvendi t’ia rekomandojmë një vendim të qartë të bazuar në diskutimet ligjore...

Besim Beqaj, tha se tani ne jemi duke diskutuar për dy projekte të cilat janë goxha gjatë në diskutim. Unë kam qenë aktor me kapacitet të ndryshëm tek të dy kompanitë, edhe me projektin e “Envidity” edhe me projektin e “Shar cem”-it. Kam opinione të ndara për dy projektet, por janë të kundërta me ato që i tha Blerimi, duke marr parasysh se “Envidity” është projekt, i cili bazohet në pritje shkencore që janë shumë të plotësuara.

Gazifikimi nëntokësor i thëngjillit ose për gazifikim, i cili është në thellësi prej 150 metrave, që realisht është e pamundur në forma tjera të përdoret si koncept. Sot besoj që jemi vetëm duke diskutuar për procedurën të cilën ne duhet ta analizojmë. Pse nuk është nis kjo më herët, sepse ka pas dilemë në Ligjin për Miniera dhe Minerale.

Çka ka qenë interes publik, paraprakisht neni 18, pika 7.1 dhe 7.2 të Ligjit për Miniera dhe Minerale duke e gazifikuar paraprakisht mundësinë që resurset tona minerale mund të përdoren edhe për prodhimet tjera përveç shfrytëzimit për energji elektrike. Debatin që ne e kemi pas për “Envidity” ka qenë se gjoja kjo formë mund të përdoret për shfrytëzim të linjtit dhe për prodhim të energjisë elektrike, e cila do të shkonte në konkurrencë me projektet tjera ekzistuese.

Do të hyjë në një negociim të drejtpërdrejt. Pra, është amendamenti i ligjit, ndërkohë është parë që ka pasur mungesa specifike.

Ngushtimet të cilat janë, në kushte normale nuk duhet të ndodhin. Dhe në këtë drejtim besoj që aspekti bazë ligjor ekziston. E dyta që unë kam pasur dilemë, ka qenë pse Kosova të jetë aq atraktive duke marrë parasysh që jemi duke folur për një trekëndësh Klinë- Istog- Pejë. Është ky trekëndësh i cili parashihet që e ka pikën themelore, ku duhet të investohet e ku duhet të bëhen shpronësime për interes privat me procedura publike.

Ne kemi pas kësaj rastesh më herët, por që kjo çështje duhet të definohet qartë, cili është përfitimi i shtetit, i qytetarëve për një shpronësim të tillë. Por kjo nënkupton që shteti duhet të bëjë ekskluzivisht vetëm procedura, ndërsa pagesa që është e definuar në projekt, duhet të bëhet nga investitori privat, për shpronësim privat të asaj hapësire, e cila mund të shfrytëzohet. Pra kemi të bëjmë me “Envidity”, me hulumtim sepse do të ishte e pasigurt që ne t’i themi dikujt hyn bën investime në hulumtim, ngase ato investime mund të kushtojnë me miliona euro. Dhe ne pasi ta bëjmë investimin, hulumtimin, nëse del me rezultate pozitive, e dërgojmë në procedurën e prokurimit publik sepse shteti duhet të bëjë hulumtime ose t’ia jep dikujt me prioritet.

Ligji për Miniera dhe Minerale i përcakton plotë zona të interesit të veçantë, kur merr vendim dhe për këtë arsye kërkohet për negociim por edhe për shfrytëzim të atyre resurseve. Një vendim edhe i Kuvendit, i cili do ta mundësonte hyrjen në negociata me kompanitë dhe përcaktimin e kriterëve të cilat pastaj do t’i vazhdojmë. Tek “Sharcem”-i kemi të bëjmë me përdorim sipërfaqësor të linjës, do të thotë, njëra është në thellësi mbi 100 metra ku parimisht do të bëhet nxjerrja, terja, grimcimi dhe shitja. Nga kuptimi ekonomik, që unë kisha dilema sa kam qenë ministër, është se a i paguhet Kosovës me e dhanë resursin e vet të papërdorur vetëm me taksën e royaltis, që ne ia paguajmë shtetit.

Kjo është logjika e projektit të “Sharcem”-it dhe që realisht, që të dyja e kanë interes të investimit në energji. Besoj që duhet të korrigjohet pak sepse as njëra e as tjetra nuk kanë kuptimin e energjisë elektrike, në kuptimin e energjisë elektrike janë emergjent, por jo prodhim i energjisë elektrike asnjëri nuk ka përfitim për palët e treta. Prandaj, nuk është interes publik investimi i cili do të mundëson që të kemi energji më të qëndrueshme.

Përndryshe unë propozoj që ne ta kalojmë dhe normalisht të hapim mundësinë që Kuvendi t’i autorizojë aspektet ligjore, mjedisore dhe është përgjegjës Komisioni për Miniera. Ne parimisht nuk duhet ta bëjmë rolin e ekspertit, për neve është me rëndësi që të hapim rrugën për diçka që mundëson Ligji dhe pastaj e tërë përgjegjësia ligjore dhe profesionale i bie te Komisioni për Miniera.

Pal Lekaj, tha edhe pse është vullnet i mirë Qeverisë për të krijuar kushte për punësim, por mbesin dilema të shumta sa i përket këtyre projekteve. Nuk ka sipërfaqe të definuar të saktë, nuk ka hartë të definuar e të precizuar se në cilën pjesë mund të ketë studim të fizibilitetit, nuk ka shënim se në cilën pjesë është pronë publike dhe private, dhe a ka biseduar dikush më këta banorë dhe a janë pajtuar ata me këtë. Nuk kemi vendim të Komunave respektive, nuk ka vendim nga Këshillat Komunale për të lejuar një investim të tillë dhe tjerë që lënë hapësira për të dyshuar për manipulime që t’i largosh nga tenderimi dhe të përcaktosh paraprakisht dy kompani dhe të thuhet që në Kuvend duhet të miratohet vetëm në parim. Cili është interesi i këtyre kompanive dhe nuk po shoh ndonjë leverdi të qytetarëve të Kosovës, përpos interesave personale të disa individëve. Nuk ia vlen të prishet ajo bukuri natyrore që mund të jetë edhe për turizëm, nuk ia vlen që vota ime të jetë për, por do të jetë kundër, sepse ju po thoni që Kuvendi

vetëm merr vendim, sa për të hapur rrugën për fizibilitet dhe për të shprehur interes publik dhe interesi publik dallon me interesin privat dhe Kuvendi nuk duhet të hyjë në këso lajthitje, kur nuk dihet historiku i kësaj kompanie që ku ka vepruar. Është shumë herët të procedohet pa debat publik për ato zona pa shqyrtim publik. Cili është saktësisht interesi nacional apo interesi i Qeverisë së Kosovës. Pa këto, mendoj që hyjmë në ujëra të turbullta dhe i japim një hapësirë investitorëve tjerë të hezitojnë të vinë në Kosovë. Prandaj, duhet të jemi të ndërgjegjshëm para investitorëve dhe qytetarëve për vendimet që i marrim në Kuvend.

Enver Hoti, tha se Ligji për Miniera dhe Minerale neni 21 pika 2.2 thekson se asnjë licencë dhe hulumtim nuk mund të jetë me e madhe se 100 kilometra katrorë, ndërsa pika 2.5 e po të njëjtit nen thekson se asnjë person, kompani nuk mund të mbaj licencë hulumtimi më shumë se 300 kilometra katrorë, prandaj, duke pasur parasysh se kërkesa e kompanisë i kalon 3000 km² KPMM-ja sugjeron që të kërkohej nga kompania modifikime edhe të shihet se kjo është ndesh me Ligjin aktual për miniera dhe minerale.

Mendoj se duhet të rishikohen akoma më shumë dhe duhet të trajtohen, duke ditur se kërkesa për licencë bie mbi një sipërfaqe shumë të madhe të territorit të Republikës së Kosovës, dhe mbi licenca aktive të lëshuara nga KPMM-ja, atëherë përveç tjerash duhet të kemi parasysh nenin 6 pika 1.5 të Ligjit si më poshtë, nuk po e lexoj se mendoj që e keni të shkruar mendoj se këto të gjitha neve na japin elemente që duhet të trajtohet edhe më tutje. Ndërsa, në piken 2 e kemi parasysh që një pjesë e madhe e resurseve prej linjtit, janë të hulumtuara dhe rezervat janë të verifikuara, të cilat janë të paraqitura në strategjinë për minierat e Republikës së Kosovës. Mendoj që nuk duhet të procedohet, po duhet akoma kohë të trajtohet më tutje kjo pjesë...

Raif Qela, theksoi se njëra prej arsyeve pse po procedohet në këtë vendim është nevoja për siguruar sigurinë e furnizimit energjetik, prodhimi, produktet finale të gazifikimit nëntokësorë që po synohet të bëhet këtu, do të jenë gazi sintetik dizeli edhe kerozina, në pjesën për tregun e jashtëm. Ta kemi parasysh jo për sigurinë vetjake, por për sigurinë e të tjerëve. Tjetra, sa i përket asaj se a ka bazë ligjore kjo që po procedohet, po ka bazë ligjore, edhe problemi është këtu se për shkak të mungesës së përcaktimit të qartë të disa prej dispozitave, qoftë edhe të asaj se çka është interesi publik, po edhe i ka disa cikërrime, ne mund të hyjmë në një situatë në të cilën më vonë e kemi problem ti themi jo, andaj, unë them sot të mos marrim vendim, ta analizojmë, ta trajtojmë, edhe të vazhdojmë ta shtjellojmë deri sa shkencëtarët e të tjerët të na bindin se kjo është në rregull dhe ta japim miratimin ose jo më vonë.

Avduallah Hoti, Ministër i Financave: Ne i kemi shqyrtuar me kujdes këto dy projekte në Qeveri, dhe unë dëshiroj edhe një herë t'i përmendi pesë kushtet që i kanë plotësuar këto dy projekte, për ti shpallë interes publik sepse ajo që po kërkohej nga ju nga Kuvendi, nëse ju vendosni ta dërgoni këtë çështje në Kuvend, është të shpallet interesi publik. Ju nuk e apromoni sot projektin. Projektin e aprovon ekipi negociues në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale dhe Ligjin për Partneritet Publiko privat, pra ne kemi konstatuar si Qeveri që projekti ndihmon në zhvillimin e përgjithshëm të ekonomisë së Kosovës, duke krijuar ambient të mirë për biznes duke tërheq investime. Nën dy, inkurajon futjen e teknologjive më të përparuar në këtë fushë. Nën tre, projekti ka vlerë kapitale së paku 30 milionë euro, është plotësuar ky kusht. Nën katër, projekti është në pajtim me standardet mjedisore përcaktuar me legjislacionin e Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Nën pesë, projekti nuk është në kundërshtim me detyrimet që ka Republika e Kosovës me marrëveshje ose me kontrata të tjera. Pra dy projektet janë në

përputhje me këto pesë kritere që i përmenda më poshtë dhe të gjitha dilemat që ju mundë ti keni këtë fazë, duhet të zgjidhen përmes ekipit negociues, me ekspertë përkatës përpara se t'i lëshohet licenca.

Unë ju sigurojë që Ligji do të implementohet në detaje me precizitet maksimal. Ju mund të keni mbikëqyrje gjatë këtij procesi si komision parlamentar këtë fazë. Unë sot po kërkoj mirëkuptimin tuaj, ta shpallni interesin publik për këto dy projekte, pastaj ta aprovojmë në procedura të rregullta ligjore dhe të mënjanohen të gjitha ato dilema që u hapen nga ju dhe nga ekspertë përkatës.

Blerim Grainca, tha se vet fakti se këto dy çështje kanë ardhur për tu diskutuar këtu, nëse kemi dallime më Besimin, për projektet të cilat kanë ka ardhur, me Palin, kemi dallime në qasje, zoti ministër, të kërkoj shpjegime dhe arsye të projektit, nuk do të thotë që ne domdoshmërisht jemi kundër projektit. Këtu të sqarohemi, ne po i kërkojmë gjitha informatat, nëse ne ia rekomandojmë Kuvendit shpalljen e interesit publik për këtë zonë, duhet edhe një pjesë tjetër e faktorëve t'i përcillet me rekomandim Kuvendit. Andaj, ne nuk mund të kërkojmë prej Kuvendit të shpallë interes publik një zonë të padefinuar ose që është aq e madhe, këtë po e kërkojmë ta e definojmë. Dy kërkesat që i pata unë, besoj se do të sqarohen në grupin për negociata dhe pjesa financiare. Andaj, unë nuk jam kundër projektit si zhvillim për interes publik, por jam kundër detajeve edhe të dhënave që janë paraqitur në projekt edhe që do të sqarohen, andaj rekomandimet duhet ti dërgohen Kuvendit më këto sugjerime për plotësim të projektit.

Raif Qela, theksoi se problem është kur po futemi në një proces, pastaj nuk po kemi mundësi që ta ndalim atë, nëse shkon në një rrugë të padefinuar. Po e përsëris, mungesa e përcaktimit të qartë në fazën përgatitore të investimeve, rreziqet e mjedisit nga ndërtimi dhe operimin e këtyre projekteve, na shtojnë që sot të mos e votojmë këtë vendim derisa të mos i sqarojmë këto çështje.

Fatmir Rexhepi, tha se për ne si Komision, këtë informatë që e dha ministri, lidhur me këto dy projekte, puna që është bërë deri më tash, natyrisht që ngrit edhe një përgjegjësi të madhe nga ne. Lidhur me procedimin e këtyre projekteve me arsyetimet të cilat u thanë këtu edhe si Komision, duhet të vendosim a duhet sot ta bëjmë këtë punë për procedim drejt Kuvendit apo na duhet edhe pak kohë ta trajtojmë këtë temë me informata shtese. Është mirë ne si anëtarë të Komisionit, ta vlerësojmë. Sugjerimi im për kolegë se paku për mua, që nuk kam qenë shumë i familjarizuar me këto projekte, dëshiroj t'i japim kohë vet Komisionit edhe një herë të takohemi lidhur me këto të bashkëbisedojmë se cilat informata shtesë duhet t'ia bashkëngjisim për procedim të mëtutjeshme për Kuvend.

Nuk është e lehtë të marrë vendim sot, për arsye se përvoja e deritanishme në gjitha negociatat në Kosovë, tash 15 vjet në të gjitha projektet që i kemi quajtur strategjike të karakterit nacional të energjisë, postës, autostradës, mendoj se në të gjitha kemi dështuar. Kemi paguar kosto jashtëzakonisht të madhe, disa prej tyre kanë marrë drejtimin nga nuk duhet, dhe Kosova ka paguar kosto të mëdha, prandaj mendoj që para procedimit, Komisioni edhe një herë të ulët, t'i shikojmë këto dy projekte se cilat rekomandime do t'i japim dhe t'i sugjerojmë Kuvendit të zhvillojë debatin për të dhënë një mendim sa më të mirë.

Ne po flasim për konkluzione, ne flasim për përgjegjësi, por në Kosovë nuk ka përgjegjësi.

Muhamet Mustafa, kryetar: Fatmir! Në qoftë se nuk ka përgjegjësi, atëherë duhet me ia mbyll derën e kësaj shtëpie, nëse nisim kështu.

Fatmir Rexhepi: Përvoja në projekte të tilla na ka dëshmuar këto gjëra, jo pse po kam dëshirë unë, cilin do njeri që e kemi autorizuar të flasë për resurset e Kosovës, ka dështuar. Unë po them, ti kërkojmë garancitë për çdo projekt që duhet të bëhet, nuk po them diçka që po e zbuloj, por nuk duhet të votojmë blanko.

Kryetari: Nuk foli askush që duhet ta votojmë blanko.

Fatmir Rexhepi: Ok, ky ishte sugjerimi im, ju vazhdoni.

Besim Beqaj: Kur po thirrem në projekte të ndryshme, është hera e parë që po diskutojmë për një projekt të tillë, sepse deri tani nuk ka pas bazë ligjore fare për të hyrë në negociata të drejtpërdrejta, dhe nuk mund të krahasohet me asnjë projekt të tjetër.

Ajo që është për definim të interesit publik se a e definon Kuvendi këtë projekt si interes publik, po, apo jo, dhe procedurat pastaj janë mbi bazën e ligjeve, duke marr parasysh se ne si Komision po kemi shumë punë të vështirë të hyjmë në gjërat, të cilat po janë edhe në kuptimin profesional. Ndoshta duke mos e pasur prezencën askujt tjetër mund të ulëm bashkërisht të diskutojmë në detaje lidhur me projektet në fjalë dhe t'i harmonizojmë rekomandimet për Kuvendin, të mos them as që i kemi anulua apo kthyer si vendime, mirëpo kemi nevojë për një konsultim shtese të brendshëm, për një riformulim për rekomandimet, të cilat ne do t'ia dërgojmë Kuvendit.

Muhamet Mustafa, kryetar: Mendoj që debati ishte më rendësi. I kuptoj plotësisht dilemat e disa kolegëve, por intenca e tyre nuk është me blloku, por me i pa të gjitha aspektet. Në këtë drejtim, ne duhet ta rrisim nivelin e rigorozitetit të konstatimit të interesit publik. Mirëpo, të arrijmë në atë mënyrë që mos të bllokojmë zhvillimin, mos t'i bllokojmë iniciativat, të mos i shkojmë deri në një shkallë që interesat e ndryshme, qofshin politike apo të tjera, t'i bllokojnë iniciativat zhvillimore, kjo është më së paku çka i duhet Kosovës. Në këtë drejtim kemi më konstatuar së pari, a ka interes publik, në qoftë se ne flasim për investime në fazën e parë 200 milionë, në dy projekte, fazën e dytë me miliarda, atëherë interesi publik ekziston, mirëpo investimet e mëdha përcillen me rrisqe. Ato rrisqe ne duhet t'i definojmë t'i menaxhojmë, janë të menaxhueshme, praktika ndërkombëtare i ka të menaxhueshme. Ne do t'i shkruajmë rekomandimet dhe t'i aprovojmë, në mbledhjen ardhshme nuk ka debat. Rekomandimet do ti nxjerrim nga debati i sotëm për Kuvend, ku ne folëm për shumë aspekte profesionale. Ka teknologji të cilat ne nuk i njohim, por nuk do të thotë që nuk i njohim mjaftë e me ia mbyll derën dhe projekteve që kanë rrisqe mos t'iu lëmë asnjë mundësi për të marrë një licencë.

Natyrisht, licenca duhet të merret në kuadër të Ligjit . Kuvendi dhe KPMM-ja nuk e lejon një gjë të tillë jashtë ligjit.

E dyta, asnjë projekt i tillë mos me hy pa e pas studimin e fizibilitetit, të punuar nga Qeveria, jo vetëm prej investitorëve, të balancohet interesi publik me atë privat. Sot ne nuk po i aprovojmë projektet, sot po i aprovojmë hulumtimet. Në qofte së dikush duhet të bëjë hulumtime me miliona, atëherë dikush më shfrytëzuar këto hulumtime, e ti atëherë të konkurrosh për investime, nuk është në rregull për projekte të tilla që kushtojnë më miliona. Procedura e marrëveshjes për hulumtime është në rregull, atë ne sot po e bëjmë deri në vendim

për po ose jo. Për projektin, ne duhet ti kemi të gjitha këto në dorë edhe studimin e mjedisit, edhe konsultimin e banorëve dhe të komunave, sepse ajo është metodologji e Bankës Botërore dhe e vlerësimit strategjik të mjedisit. Por ne nuk mundemi në këtë fazë me blloku nisjen e punëve. Prandaj, ajo që na duhet, Kuvendi ka hyre në procedurë dhe ne nuk mundemi me e ndal, duhet t'ia rekomandojmë Kuvendit, për ti ndihmuar që të marrë vendim. Do ti riformulojmë rekomandimet më kujdes, do ta dëgjojmë edhe një herë debatin e mbledhjes dhe në mbledhjen tjetër i aprovojmë, a pajtoheni?

Komisioni, e aprovoj propozimin e kryetarit dhe e autorizoi stafin e Komisionit që ta transkriptojë këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme.

Kërkesa për radhitje ne rend dite për seancën e radhës plenare Projektligjin Nr.05/L-079 për investime strategjike në Republikën e Kosovës

Muhamet Mustafa, kryetar, tha se pas komunikimit me kryetarin e Kuvendit, na është kërkuar që duhet të konsultohemi më Departamentin Ligjor të Kuvendit, për të përmirësuar Amendamentin 32 të Projektligjit Nr.05/L-079 për Investime Strategjike në Republikën e Kosovës dhe se versioni në Projektligj është si vijon:

Amendamenti 32

Neni 22, ndryshohet si vijon:

Neni 22

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme shoqërore për investime strategjike, në bazë të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të thjeshtë të votave.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike, përkatësisht komunale për investime strategjike vetëm pas vendimit me shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës, përkatësisht Kuvendit të Komunës përkatëse.

Ndërsa, tash propozohet teksti si vijon:

Amendamenti 32

Neni 22, ndryshohet si vijon:

Neni 22

Bartja e të drejtës së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme publike dhe shoqërore tek investitori i interesuar

1. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme shoqërore për investime strategjike në bazë të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, vetëm pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës të marrë vendim me shumicë të thjeshtë të votave.

2. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme publike për investime strategjike vetëm pas vendimit më shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

3. Qeveria e Republikës së Kosovës mund të bartë të drejtën e shfrytëzimit të një prone të paluajtshme komunale për investime strategjike, vetëm pas vendimit më shumicë të thjeshtë të votave të Kuvendit të Komunës përkatëse.

Komisioni e përkrahu propozimin e kryetarit dhe e autorizoi që ti dërgohet Kryesisë kërkesë që të procedohet ky Projektligj për miratim në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa